



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 dhjetor 2016  
Nr. ref.:RK1012/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI133/15**

Parashtrues

**Granit Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ. UZVP. nr. 25/2015, të 30 shtatorit 2015**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Granit Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), banor i Prishtinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP, nr. 25/2015, të 30 shtatorit 2015, me të cilin janë vërtetuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me aktvendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHC).
3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 tetor 2015.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP, nr. 25/2015, për të cilin pretendohet shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 5 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 8 dhjetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).
8. Më 16 dhjetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 29 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy, kryesues të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.
10. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Me vendimin e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, nr. 01/990, të 15 tetorit 2012, parashtruesi i kërkesës u suspendua me pagesë nga puna, për paaftësi profesionale dhe keqadministrim, deri në një vendim të Komisionit Disiplinor.

12. Më 5 qershor 2013, Komisioni Disiplinor (në kuadër të Qeverisë), mori Vendimin nr. 02/2013 për transferimin e parashtruesit nga pozita e mëparshme menaxhuese, në një pozitë me përgjegjësi më të ulët, por pa e humbur gradën funksionale.
13. Parashtruesi, bazuar në nenin 78 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, parashtroi ankesë në KPMSHC.
14. Më 16 shtator 2013, KPMSHC (Vendimi, A nr. 02/266/2013), vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor, duke konstatuar se ky komision e bazoi vendimin e tij në vlerësimin e mbikëqyrësit të parashtruesit të kërkesës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht me nenin 33, paragrafin 2 (3) dhe nenin 34, paragrafët 2 dhe 4.
15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, kundër vendimit të KPMSHC-së, duke kërkuar anulimin e vendimit të KPMSHC-së, si të kundërligjshëm.
16. Më 13 janar 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, refuzoi, si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Kjo Gjykatë gjeti se *“KPMSHCK ka marrë vendim të drejtë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-139) neni 67, par. I, nën paragrafi I.2, pika 1, 2, 3 dhe neni 51 par. 2, si dhe Rregulloren Nr. 02/20 II për rregullat dhe procedurat e ankesave në KPMSHC. Po ashtu, Gjykata gjeti se në rastin konkret drejtë janë zbatuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2012 - Për pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Kosovës, neni 10 par. 4 pika 4.1, neni 9, par 3.4 dhe neni 19”*.
17. Parashtruesi, në një datë të paspecifikuar, apeloj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës në Gjykatën e Apelit.
18. Më 24 mars 2015, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
20. Më 30 shtator 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimin ARJ-UZVP nr. 25/2015), la në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.
21. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme, ndër të tjera, theksoi:

*“Sipas nenit 33 të Ligjit nr. 03/ L-149 për KPMSHCK është përcaktuar se në çdo institucion të administratës qendrore dhe komunale kryhet periodikisht, në fund të çdo viti, vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civil. Vlerësimi i rezultateve në punë kryhet me qëllim të rritjes së suksesit të punës dhe për të siguruar përmirësimin gradual të aftësisë profesionale dhe të cilësisë së shërbimeve administrative. Mbikëqyrësi është i detyruar*



*të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë. Neni 34. par. 2 dhe 3 parashikon se rezultatet e vlerësimit të punës përdoren për të siguruar të dhënat për ankuesin dhe për t'i mundësuar atij që të përmirësojë punën e tij dhe do të merreshin parasysh rezultatet e vlerësimit të punës gjatë procedurave disiplinore. Edhe neni 51, par.2 i të njëjtit Ligj përcakton se Nëpunësit civil janë të obliguar që të mbështesin dhe të lehtësojnë zbatimin e politikave të miratuara nga administrata publike. Mbi këtë gjendje të fakteve, me vendimin e Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë me nr. 01/990 të datës 15.10.2012 paditësi është pezulluar nga puna me pagesë 50% të pagesës, për shkak të paqftësisë profesionale dhe keq administrimit. Komisioni disiplinor me Vendimin KD 02/2013 dt.05.06.2013 ka zhvendosur paditësin në një pozite në përgjegjësi me të ulëta menaxhuese por pa e humbur gradën funksionale, ndërsa me Vendimin e KPMSHC me nr. 02/266/2013 dt.16.09.2013 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër vendimit të Komisionit disiplinor”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, për shkak të mosarsyetimit të vendimit nga Gjykata Supreme dhe mosdeklarimin e saj, përkitazi me përmbajtjen (thelbin) e kërkesëpadisë.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës “... Asnjë nga vendimet e gjykatave vendore nuk ka trajtuar në përmbajtje faktin se a janë respektuar dispozitat ligjore të cekura në ankesat dhe kërkesat e tij në mënyrë që ai të shkarkohet nga pozita që kishte dhe të transferohet në pozitë më të ulët me pagë të njëjtë...rrjedhimisht nuk mund të përfundohet se rasti i parashtruesit të kërkesës është arsyetuar dhe është si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë material”.
24. Më tutje, parashtruesi pretendon se “... në procedurën e zhvilluar të organet e Ministrisë dhe në Këshillin Mbikëqyrës ishin shkelur dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil (nr. 03/L-149), Rregullores nr. 06/2012 dhe nga Gjykata dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar”.
25. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, pretendon se “... përfundimet e Gjykatës paraqesin diskriminim në zbatimin e ligjit në rastin e parashtruesit të kërkesës. Gjithashtu përfundimi i Gjykatës për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës në konflikt administrativ është diskriminim tjetër në zbatimin e ligjit”.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

28. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

29. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës, parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.*

30. Për më tepër, rregulli 36 (2) (b) i Rregullores së punës, specifikon:

*“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë të si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(...)*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, për shkak të mosarsyetimit të Aktgjykimit nga Gjykata Supreme dhe mosdeklarimit të saj lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesëpadi.

32. Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, që përcakton:

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet (...)”.*

33. Përveç kësaj, neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], përcakton:

*“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile (...), çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.*

34. Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, duke vendosur për kërkesën e jashtëzakonshme të ushtruar nga parashtruesi, ndër të tjera, gjeti: *“Të pabazuara janë thëniet e paditësit lidhur me shkeljet sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, ngase aktgjykimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e*



*vendimeve të ligjshme. Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit dhe është bërë aplikimi i drejtë i të drejtës materiale”.*

35. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, nuk argumentohen në mënyrë bindëse. Ato pretendime, kryesisht ndërlidhen me mënyrën e gjetjes dhe vlerësimit të fakteve dhe të aplikimit të ligjit material. Gjykata, gjithashtu, vëren se Gjykata Supreme i trajtoi të gjitha ankesat e parashtruesit të ngritura para saj, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për secilën prej tyre.
36. Gjykata thekson se vetëm referimi i thjeshtë në dispozita të Kushtetutës, si dhe pretendimi se ato janë shkelur pa paraqitur argumente bindëse dhe pa sqaruar rrethanat që kanë çuar në një shkelje të tillë, të pretenduar nga ana e autoritetit publik a gjykatat, nuk ofron bazë të mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
37. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që pretendimi i parashtruesit të kërkesës, se procedura e zhvilluar në Gjykatën Supreme ka qenë e padrejtë dhe shkel të drejtën për gjykim të drejtë, respektivisht të drejtën për një vendim të arsyetuar është qartazi i pabazuar
38. Më tutje, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se organet e Ministrisë së Tregtisë dhe KPMSHC, shkelën dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil, nr. 03/L-149, dhe dispozitat e Rregullores nr. 06/2012, si dhe gjykatat e rregullta aplikuan në mënyrë të kundërligjshme dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, nr. 03/L-202.
39. Përkritazi me këtë, Gjykata thekson se një pretendim i tillë ngre çështje të ligjshmërisë, dhe është juridiksion i gjykatave të rregullta.
40. Gjykata, thekson me tej, se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu, rastin *KI70/11*, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
41. Në juridiksionin e Gjykatës është të vërtetojë nëse, në përgjithësi, procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë korrekte dhe të drejta në tërësi (Shih, ndër të tjera rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
42. Fakti i thjeshtë, se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë që ai mund të ngre një kërkesë të suksesshme dhe të pranueshme, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij/saj të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.
43. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk tregojnë se Gjykata Supreme ia ka mohuar atij të drejtat e

garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

44. Rrjedhimisht, në baza kushtetuese kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2016, njëzëri

### **VENDOS**


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Bekim Sejdiu



**Kryetaria e Gjykatës Kushtetuese**

  
Arta Rama-Hajrizi